

VENDIM
Nr. 10, datë 6.2.2014

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KESH” SHA PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË**

Në mbështetje të neneve 9; 13, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 7; 149 dhe 150 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “KESH” sh.a., në aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 3.6.2008, me një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti